



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par. 1 pika b të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt.16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më dt. 24.07.2007 merr

**V E N D I M**  
**MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR SHKOLLËN SPECIALE NË**  
**LAGJEN “KALABRIA” NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shkollës Speciale në lagjen “Kalabria”.

**Neni 2**

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshihet në ngastrën 2903/2 KK Prishtinë, të evidencuar në fletën poseduese nr. 4137, pronë e Kuvendit të Komunës, në një sipërfaqe rreth 30.00 arë.

**Neni 3**

Ky vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuar për realizimin e këtij vendimi.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**№ 01. 353-308, më. 24.7.2007**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**